



# **PLANI STRATEGJIK I CIVIKOS 2018-2022**

Prishtinë, 2017

## Për CIVIKOS

Platforma CiviKos është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile, të përkushtuara për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Platforma CiviKos u themelua në shtator të vitit 2007, ndërsa dy muaj më vonë nënshkroi, në emër të organizatave të shoqërisë civile, memorandumun e bashkëpunimit me Qeverinë e Kosovës. Me konsolidimin e Sekretariatit, në fillim të vitit 2012, Platforma CiviKos, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, përkrahu procesin e hartimit të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, e cila u aprovua në korrik të vitit 2013. Kjo Strategji hapi rrugët edhe për krijimin e bashkëpunimit formal mes Qeverisë dhe shoqërisë civile. Aktualisht Platforma CiviKos ka një anëtarësi prej 207 organizatash e që është vazhdimisht në rritje.

### **Kontakt:**

Platforma CIVIKOS

Rr. "Bedri Pejani", nr. 7/A,

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 224 904, +383 (0) 38 224 904

E-mail: [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net)

Web: [www.civikos.net](http://www.civikos.net)

## Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive.....	4
1. Hyrje .....	6
2. Historiku i shkurtër i CIVIKOS.....	6
3. Konteksti i veprimit.....	7
3.1. Sfidat dhe mundësitë e mjedisit .....	8
3.2. Palët me interes .....	9
3.3. Analiza e gjendjes.....	11
3.3.1. Zhvillimi i organizatës .....	11
3.3.2. Anëtarësia në CiviKos .....	12
3.3.3. Bashkëpunimi me autoritetet publike.....	13
3.3.4. Marrëdhëniet me publikun .....	14
4. Vizioni dhe misioni .....	15
5. Objektivat strategjike.....	16
Objektivi Strategjik 1: Menaxhim efektiv, transparent dhe llogaridhënës.....	16
Objektivi Strategjik 2: Mobilizim i organizatave anëtare .....	20
Objektivi Strategjik 3: Avancimi i dialogut .....	22
Objektivi Strategjik 4: Promovimi i punës.....	25
6. Burimet për zbatimin e Strategjisë .....	31
7. Plani i veprimit .....	32
8. Monitorimi i Strategjisë .....	40

## Përmbledhja ekzekutive

Strategjia e CiviKos 2017-2022 ka për qëllim të përcaktojë rrugën e zhvillimit të organizatës brenda një periudhe 5-vjeçare kur CiviKos përmbyll një cikël të suksesshëm 5-vjeçar të aktivitetit të vet, i cili ka rezultuar me përmirësim të dukshëm të bashkëpunimit në mes të Qeverisë dhe të shoqërisë civile.

Procesi i planifikimit strategjik ka qenë i strukturuar mirë dhe është karakterizuar me pjesëmarrje të gjerë të stafit dhe Bordit të CiviKos, por edhe me kontribut domethënës të organizatave anëtare dhe përfaqësuesve të institucioneve qendrore të Kosovës. Hapi i parë ka qenë analiza e mjedisit të jashtëm dhe analiza e gjendjes në CiviKos, me ç’ rast janë identifikuar dhe diskutuar sukseset dhe dobësitë e organizatës, si dhe mundësitë dhe rreziqet që qëndrojnë në rrugën e zhvillimit të CiviKos. Pastaj, janë riformuluar vizioni dhe misioni i CiviKos që reflektojnë zotimet afatgjata të Platformës.

**Vizioni:** Kosova, shoqëri e vlerave demokratike e udhëhequr nga parimet e transparencës, integritetit, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes.

**Misioni:** Mobilizimi i potencialit të organizatave të shoqërisë civile për krijimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike

Në procesin e planifikimit janë identifikuar katër objektiva strategjike për periudhën 2018-2022:

### **1. Menaxhim efektiv, transparent dhe llogaridhënës i Platformës CiviKos**

Për ta arritur këtë objektiv do të punohet në avancimin e procedurave që ka Platforma CiviKos dhe përplotësimin e tyre me procedura të reja që avancojnë funksionimin e Platformës. Krahas kësaj, do të ndërtohen kapacitete njerëzore dhe materiale për menaxhim të mirë, duke avancuar në shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Qasja pro-aktive për sigurimin e fondeve i kontribuon drejtpërdrejt qëndrueshmërisë së Platformës, ndërsa shtrirja e saj në të gjitha rajonet e Kosovës zgjerimit të veprimtarisë dhe ndikimit të Platformës në nivelin lokal.

### **2. Mobilizim i organizatave anëtare përmes ndërveprimit të vazhdueshëm dhe ofrimit të shërbimeve cilësore**

Platforma CiviKos mund ta përmbushë misionin e vet për lehtësimin e bashkëpunimit në mes të Qeverisë dhe të Shoqërisë Civile vetëm nëse ia del t’i mobilizojë organizatat anëtare që të jenë pjesë e këtij procesi. Përveç ndërtimit të kapaciteteve të vet Platformës, e që përfshihet në objektivin 1, duhet siguruar që organizatat anëtare të kontribuojnë në punën e Platformës, jo vetëm duke qëndruar prapa aktivitetit të saj, por edhe duke ofruar mbështetje konkrete për të. Po ashtu, duhet përcaktuar qartë shërbimet që ofron Platforma për organizatat anëtare, duke përmirësuar në vazhdimësi cilësinë e tyre. Dhe, në fund, mobilizimi i mirëfilltë nuk është i mundur pa një konsolidim të mirëfilltë të anëtarësisë, qoftë duke përcaktuar nivele të ndryshme të pjesëmarrjes në aktivitetet e bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile ose duke ndihmuar organizatat anëtare që t’i përmbushin kërkesat që shtrihen para tyre vet anëtarësia në Platformën CiviKos.

### **3. Avancimi i dialogut të strukturuar në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike**

Dialogu në mes të autoriteteve publike dhe shoqërisë civile është instrumenti kryesor përmes të cilit realizohet bashkëpunimi i mirëfilltë në mes të këtyre subjekteve. Procesi i hartimit të strategjisë së re për bashkëpunim Qeveri-Shoqëri Civile për periudhën 2018-2022 tanimë ka filluar dhe Platforma CiviKos shihet si një lloj përfaqësuese e interesit të shoqërisë civile në këtë proces. Pas hartimit të Strategjisë së re, përqendrimi i CiviKos do të jetë në lehtësimin e bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile, duke bërë të mundur një përfshirje sa më të gjerë të organizatave të shoqërisë civile, e në përputhje me mundësitë dhe interesat e tyre. Një ndërmarrje e re strategjike është shtrirja e bashkëpunimit me autoritetet publike të nivelit lokal që do të kërkojë mjaft angazhim nga Platforma CiviKos, qendra rajonale dhe organizatat anëtare që punojnë në nivelin lokal.

### **4. Promovimi cilësor i punës dhe rezultateve të CiviKos dhe organizatave anëtare**

Pavarësisht se sa efektive është puna brenda një organizate, ajo nuk bën ndikimin e dëshiruar, nëse palët me interes dhe publiku i gjerë nuk kanë informacion për sukseset dhe kontributet e organizatës. Kjo është arsyeja e përfshirjes së promovimit në planin strategjik të Platformës CiviKos. Në këtë formë, informohen palët me interes dhe publiku i gjerë për kontributin e Platformës dhe anëtarësisë së saj, rritet reputacioni i Platformës në sytë e publikut, si dhe krijohen mundësi për të siguruar fonde të reja. Përqendrimi do të jetë tek qasja më profesionale ndaj promovimit të punës së Platformës CiviKos dhe anëtarëve të saj në mënyrë që mesazhet e duhura të përcillen në adresat e duhura dhe të bëjnë efektin e dëshiruar.

Për secilin objektiv strategjik janë definuar aktivitetet dhe treguesit e suksesit që shërbejnë për vlerësimin e progresit. Po ashtu është hartuar një plan i detajuar i aktiviteteve për periudhën vijuese pesëvjeçare, si dhe janë bërë kalkulime buxhetore për të vlerësuar koston e zbatimit të Strategjisë.

## 1. Hyrje

Në periudhën 2015-2017 puna e Civikos është mbështetur në masë të madhe në dokumentin “Objektivat strategjike të Platformës Civikos 2015-2017”, i cili përcakton tri fusha kryesore veprimit të Platformës Civikos: 1) Shërbimet për anëtarë dhe raportet me organizata të shoqërisë civile; 2) Koordinimin e shoqërisë civile për zbatimin e strategjisë; 3) Zhvillimin e dialogut në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Procesi i hartimit të Strategjisë 5-vjeçare u iniciua nga Bordi dhe Sekretariati i Platformës Civikos në qershorin e vitit 2017, gjashtë muaj para skadimit të strategjisë aktuale.

Qëllimi ishte të sigurohet një proces i planifikimit me pjesëmarrje që do të siguronte ndërtimin e konsensusi të gjerë të organizatave anëtare për kahet e veprimit të Platformës në periudhën vijuese 5-vjeçare. Po ashtu, ideja ishte që ky dokument të shërbejë si mjet për prezantimin e planeve të Platformës para donatorëve, si dhe si bazë për monitorimin e veprimtarisë së saj.

Procesi i planifikimit strategjik u zhvillua në periudhën korrik-shtator 2017. Fillimisht, u formua një grup për planifikim i përbërë nga Sekretariati dhe një pjesë e anëtarëve të Bordit. Pas kësaj, u përcaktua metodologjia e planifikimit, me të cilën parashihej mbajtja e dy punëtorive planifikuese 1.5 ditore. Punëtorja e parë u mbajt në fillim të muajit gusht dhe iu kushtua analizës së gjendjes. Ndërkaq, punëtorja e dytë, e cila u mbajt një muaj më vonë, u përqendrua në përcaktimin e vizionit dhe misionit të Platformës, si dhe të objektivave strategjike, aktiviteteve dhe treguesve të suksesit për periudhën vijuese 5-vjeçare. Pjesëmarrja në të dy punëtoritë ishte e lakmueshme, si në aspektin përfaqësues, ashtu edhe atë cilësor. Përveç anëtarëve të Bordit dhe të Sekretariatit, kontribuan edhe përfaqësues organizatave anëtare dhe partnerë qeveritarë. Mbështetja logjistike për këto dy punëtori u ofrua nga Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE).

Si rezultat i punëtorisë së parë u hartua përshkrimi narrativ i gjendjes i dhënë në kapitullin 3 të këtij dokumenti, ndërsa kapitujt 4 dhe 5 janë rezultat i drejtpërdrejtë i punëtorisë së dytë. Pastaj, procesi vazhdoi me hartimin e një planit të veprimi dhe buxhetit për zbatimin e Strategjisë – kapitujt 6 dhe 7. Kështu, u bë i mundur hartimi i draftit të Strategjisë, i cili u qarkullua për diskutim tek Bordi i Civikos, para se të merr formën e vet përfundimtare.

## 2. Historiku i shkurtër i CIVIKOS

Platforma Civikos është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile, të përkushtuara për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Platforma Civikos u themelua në shtator të vitit 2007, ndërsa dy muaj më vonë, pas një procesi të gjatë konsultimesh me pjesëmarrjen e mbi 130 organizatave të shoqërisë civile, nënshkroi, memorandumit e bashkëpunimit me Qeverinë e Kosovës – Shoqëri Civile, në cilësinë e përfaqësueses së kësaj të fundit. Ky

memorandum paraqet dokumentin e parë formal për bashkëpunim dhe partneritet në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile. Për shkak të zhvillimeve të brendshme, CiviKos kaloi një periudhë të pasivitetit në vitet 2008 dhe 2009, ndërsa rifilloi aktivitetin në korrik të vitit 2010 me ndihmën e organizatave anëtare. Deri në dhjetorin e vitit 2011 CiviKos veproi në lokalet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), i cili ofroi burimet e nevojshme humane dhe materiale për rivitalizimin e Platformës, si dhe mbështetje financiare bashkë me Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Me emërimin e drejtorit ekzekutiv dhe konsolidimin e Sekretariatit, në fillim të vitit 2012, Platforma CiviKos, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, përkrahu procesin e hartimit të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, e cila u aprovua në korrik të vitit 2013 bashkë me planin e veprimit për periudhën 2013-2017. CiviKos, në përkrahje të hartimit të Strategjisë, ka kontraktuar ekspertët/organizatat vendore që t'i bëjnë tria analiza komplekse që kanë kontribuar në hartim të strategjisë dhe kontribuojnë në zbatimin e saj. Këto analiza janë të publikuara në web-faqen e Platformës CiviKos. Strategjia paraqet bazat e bashkëpunimit të Qeverisë me shoqërinë civile në Kosovë, duke e obliguar Qeverinë e Republikës së Kosovës që të angazhohet fuqishëm në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile. Zyra për Qeverisje të Mirë, e mandatuar nga Kryeministri për zbatimin e strategjisë, me ndihmën e CiviKos-it, është përgjegjëse për koordinimin e gjithë procesit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, ndërsa për të siguruar një qasje të pavarur në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e suksesit të zbatimit të kësaj Strategjie është themeluar Këshilli i përbashkët me pjesëmarrjen e të dyja palëve.

Një nismë tjetër e CiviKos është hartimi i standardeve minimale për procesin e konsultimit publik, punë kjo e filluar që në vitin 2015 me hartimin e një draft dokumenti nga Fondacioni Kosova për Shoqëri Civile (KCSF). Ky dokument është diskutuar për dy vjet me Qeverinë derisa është aprovuar nga kjo e fundit, duke krijuar një sistem transparent të konsultimit publik në lidhje me vendimet e rëndësishme që merr shteti.

Për të qenë sa më afër organizatave që operojnë në nivelin lokal në tërë Kosovën, Sekretariati i Platformës CiviKos në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja, ka themeluar 5 qendra rajonale në Ferizaj, Kamenicë, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë. Këto qendra ofrojnë komunikim (reagim) dhe informim mbi procesin e përgjithshëm të pjesëmarrjes civile, partneritet specifik, si dhe dialog, bashkëpunim dhe konsultime të tjera të udhëhequra nga CiviKos-i ose nga OSHC-të tjera që janë mbështetur nga Platforma CiviKos, në regjionet e tyre, duke përfshirë edhe organizatat që nuk janë anëtare në Platformën CiviKos dhe për të rritë bashkëpunimin.

Aktualisht Platforma CiviKos ka një anëtarësi prej 207 organizatash e që është vazhdimisht në rritje.

### **3. Konteksti i veprimit**

Konteksti në të cilin vepron CiviKos ka të bëjë me faktorë që janë, në masë të madhe, jashtë ndikimit të organizatës, por edhe me palët që kanë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për veprimtarinë e Platformës. Kjo ka qenë arsyeja për të analizuar mjedisin nga këndvështrime të ndryshme që kanë ndikim në punën e Platformës, duke identifikuar elementet që duhet të merren parasysh me rastin e hartimit të Strategjisë.

### 3.1. Sfidat dhe mundësitë e mjedisit

Analiza e faktorëve të jashtëm është bërë në punëtori planifikimi, përmes metodës PEST, e cila fokusohet në faktorët Politikë, Ekonomikë, Socialë dhe Teknologjikë. Më poshtë janë përmbledhur rezultatet kryesore të kësaj analize.

#### Faktorët politikë

**Politikat dhe mekanizmat qeveritarë për bashkëpunim me shoqërinë civile.**- Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, e hartuar me kontributin e Platformës CiviKos, tanimë ka filluar të tregojë rezultate pozitive. Në fillim të vitit 2017 ka hyrë në fuqi Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik. Kjo rregullore përcakton një numër të obligimeve që Qeveria duhet t'i plotësojë gjatë procesit të konsultimit publik, e të cilat ofrojnë mundësi për shoqërinë civile që të kontribuojë në procesin e politikëbërjes në nivel të Qeverisë. Ndërkaq, në qershorin e vitit 2017, Qeveria ka aprovuar Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, duke diktuar rregullat për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile përmes fondeve publike, sipas standardeve të transparencës, meritokracisë dhe zbatimit të plotë të ligjeve në fuqi.

**Legjislacioni relevant për veprimtarinë e OJQ-ve.**- Në përgjithësi, legjislacioni në Kosovë ofron kushte mjaft të volitshme për veprimtarinë e organizatave joqeveritare. Ligji për lirinë e asociimit dhe Ligji për sponsorizime janë në proces të rishikimit dhe pritet të ofrojnë kushte edhe më të mira për organizatat e shoqërisë civile. Ndërkaq, legjislacioni i punës nuk i shkon shumë për shtati sektorit joqeveritar i cili, shpesh, është i detyruar t'i bëjë punësimet me kohëzgjatje të kufizuar, në bazë të projekteve, që dekurajohet nga ligjvënësi. Po ashtu, fillimi i implementimit të legjislacionit për sigurime shëndetësore mund të shkaktojë barrë shtesë për OJQ-të, duke i bërë ato që të jenë më pak të konkurrueshme gjatë aplikimit për fonde.

**Politikat grantdhënëse të donatorëve.**- Kohëve të fundit janë paraqitur ndryshime në politikat e grantdhënies që mund të ndikojnë në funksionimin e organizatave të shoqërisë civile. Disa donatorë janë orientuar që të punojnë më shumë me organizata lokale. Po ashtu, ka përcaktime të donatorëve që grantet të jenë më të mëdha dhe t'u jepen organizatave me kapacitet më të madh shpenzues, të cilat pastaj duhet ta shpërndajnë një pjesë të tyre tek organizatat tjera, përmes procesit të ri-grantimit.

**Procesi i integritimit evropian.**- Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian parasheh obligimin e Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile, ndërsa procesi i monitorimit të zbatimit të kësaj marrëveshje mund të ketë efekt pozitiv në kontekstin kosovar, pasi nxitë respektimin e politikave të proklamuarra për bashkëpunim.

#### Faktorët ekonomikë

**Burimet njerëzore.**- Pa dyshim se cilësia e burimeve njerëzore ka ndikim të drejtpërdrejtë në punën që bëjnë organizatat joqeveritare dhe në suksesin e tyre. Për shkak të rrethanave objektive, organizatat joqeveritare ndodhen, shpesh, para rrezikut që të humbin stafin e kualifikuar, pasi në treg ka oferta financiare atraktive që karakterizohen me një stabilitet të vendit të punës.



**Varësia nga fondet e donatorëve.**- Edhe pse Platforma CiviKos është rrjet i organizatave joqeveritare, për shkak të rrethanave objektive, ka një shkallë të lartë të varësisë nga fondet e donatorëve. Ndërkaq, politikat grantdhënëse të donatorëve, të përshkruara më lartë, nuk i shkojnë gjithnjë për shtati nevojave të Platformës. Prandaj, mbetet të analizohet mundësia për diversifikimin e fondeve të donatorëve, si dhe për sigurimin e të hyrave nga burime të tjera, siç është anëtarësia ose fondet qeveritare.

## **Faktorët socialë**

**Perceptimi publik për punën e OJQ-ve.**— Organizatat joqeveritare shpesh shihen nga media si entitete që shfrytëzojnë paratë e donatorëve për të dhënë paga të mëdha. Ndonjëherë perceptimet e tilla ndikojnë tek qëndrimi i rezervuar i publikut ndaj organizatave të shoqërisë civile, duke mos e vlerësuar kontributin e tyre në shoqëri. Megjithatë, sondazhet e ndryshme e radhisin shoqërinë civile në mesin e sektorëve më të besueshëm në Kosovë.

**Mosnjohja e rolit të OJQ-ve në shoqëri.**- Meqë Kosova nuk ka ndonjë traditë të veprimit të organizatave të shoqërisë civile, ka pritje joreale në lidhje me rolin dhe kapacitetet e tyre. Në rastin e CiviKos kjo reflektohet përmes kërkesave të kohëpaskohshme për përfshirjen e Platformës në veprimtari që nuk janë në përputhje me misionin e saj.

**Fenomeni i “apatisë qytetare”.**- Mungesa e besimit se nismat qytetare ose reagimi qytetar mund të bëjnë ndonjë ndryshim në shoqëri është shkaktar i qëndrimit pasiv të një pjese të qytetarëve, që, pastaj, vështirëson nismat e shoqërisë civile për mobilizim qytetar.


## **Faktorët teknologjikë**

Mbi 80% e popullsisë së Kosovës ka qasje në Internet, prandaj shfrytëzimi i teknologjisë paraqet rrugën më të mirë për komunikim të vazhdueshëm dhe për informim të drejtë. Nga ana tjetër, pajisjet e reja teknologjike, si ato harduerike, ashtu edhe softuerike, sjellin mundësi të reja për avancimin e punës të një rrjeti kompleks siç është CiviKos.

## **3.2. Palët me interes**

Palët që kanë interes në punën e CiviKos janë ndarë në tri kategori, sipas shkallës së ndikimit të tyre në punën e Platformës, siç është prezantuar në Figurën 1.

**Figura 1.** Analiza e palëve me interes



Në kategorinë e palëve me interes që kanë **ndikim të madh** në punën e Civikos bëjnë pjesë Bordi dhe të punësuarit. Bordi përbëhet nga përfaqësues të organizatave anëtare të Civikos dhe, si i tillë, është një “ndërmjetësues” në mes të Kuvendit të Civikos dhe menaxhmentit të Platformës. Bordi është mjaft i përkushtuar dhe mban takime të shpeshta, por ekziston një trend për fuqizimin e menaxhmentit, duke i kaluar autorizimet tek drejtori ekzekutiv. Punonjësit e Civikos janë luajalë ndaj organizatës dhe i kryejnë detyrat e tyre me ndërgjegje të lartë. Pa dyshim se vendet e tyre të punës dhe mirëqenia personale dhe familjare e tyre janë të ndërlidhura me mbarëvajtjen e punës së Civikos. Megjithatë, ekziston mundësia e largimit të disa anëtarëve të stafit për shkak të ofertave më të mira financiare ose sigurisë më të lartë të vendit të punës.

Palët me interes me **ndikim mesatar** në veprimtarinë e Civikos janë organizatat anëtare, Qeveria dhe donatorët. Shumica e organizatave anëtare e shohin Civikos-in si përfaqësues të tyre karshi Qeverisë dhe i vlerësojnë shërbimet që ofron Platforma për anëtarët e vet. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i organizatave anëtare nuk kontribuojnë në masë të duhur në funksionimin e Platformës, duke u kufizuar vetëm në ato çështje që kanë të bëjnë me interesat e tyre të drejtpërdrejta. Kjo qasje edhe ka bërë që ato të klasifikohen në kategorinë e palëve me ndikim mesatare, edhe pse, dëshira e Bordit dhe menaxhmentit të Platformës do të ishte që ato të jenë në kategorinë e palëve me ndikim të madh. Ndërkaq, Qeveria e sheh Civikosin si një pikë komunikimi me organizatat e shoqërisë civile. Edhe pse jo të gjithë kanë njohuri për rolin e Civikosit dhe tregojnë gatishmëri për të forcuar bashkëpunimin me Rrjetin, zyrtarët që ndërveprojnë me Civikosin e shohin këtë si partner në forcimin e bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile. Donatorët kanë treguar qëndrim pozitiv dhe mbështetës ndaj Civikosit, duke e perceptuar rrjetin si një transmetues të zërit të shoqërisë civile, prej e cilit pritet t’i kontribuojë demokratizimit të vazhdueshëm të vendit.

OJQ-të joanëtare dhe media bëjnë pjesë në kategorinë e palëve me interes që kanë **ndikim të vogël** në punën e Civikos. Përkundër qëndrimit dominues pozitiv, ekziston një lloj rivaliteti ndaj Civikosit nga disa organizata të shoqërisë civile. Në përgjithësi, organizatat joanëtare, po ashtu, përfitojnë nga arritjet e

CiviKos në dialog me Qeverinë dhe e shohin CiviKosin si aleat për arritjen e progresit në këtë drejtim. Mediat, jo gjithëherë, kanë informacion të mjaftueshëm për punën e CiviKosit dhe e bazojnë raportin e vet me rrjetin në raportet personale me menaxhmentin e tij. Megjithatë, CiviKosi është burim i rëndësishëm i informacionit mediatik për sektorin e shoqërisë civile.

### 3.3. Analiza e gjendjes

Analiza e gjendjes është realizuar përmes metodës SWOT në punëtorinë e mbajtur më 3 dhe 4 gusht të vitit 2017. Gjatë kësaj punëtorie janë analizuar me kujdes sukseset dhe dobësitë e CiviKosit, si dhe mundësitë dhe rreziqet që lidhen me të ardhmen e Platformës. Analiza SWOT është përqendruar në katër fusha të ndërlidhura në mes vete:

1. Zhvillimi i organizatës
2. Anëtarësia e CiviKos
3. Bashkëpunimi me autoritetet publike
4. Marrëdhëniet me publikun

Fusha 1 (“Zhvillimi i organizatës”) është bërthama për funksionimin e mirë dhe forcimin e mëtutjeshëm të Platformës. Kjo fushë përfshin zhvillimin e kapaciteteve dhe aspektet menaxhuese, administrative dhe financiare të funksionimit të CiviKosit. Si e tillë ajo paraqet bazën për veprimtari në tri fushat e tjera. Fusha 2 (“Anëtarësia e CiviKos”) ka të bëjë me legjitimitetin e Platformës, pasi nga numri i anëtarëve, mënyra e përfshirjes së tyre dhe aktiviteti i tyre brenda Platformës, në masën më të madhe, varet kapaciteti i Platformës në raport me palët e treta. Kjo, në veçanti, ndikon në fushën 3 (“Bashkëpunimi me autoritete publike”), pasi një anëtarësi e strukturuar mirë dhe aktive i jep fuqi pozicionit të CiviKos në kuadër të këtij bashkëpunimi. Përveç kësaj, fusha 3 ndërlidhet me instrumentet e përfaqësimit të interesave të organizatave të shoqërisë civile karshi autoriteteve publike. Fusha 4 (“Marrëdhëniet me publikun”) përqendrohet në paraqitjen e CiviKosit në media dhe në ndërtimin e imazhit të Platformës si përfaqësues i interesave të organizatave të shoqërisë civile.

#### 3.3.1. Zhvillimi i organizatës

CiviKos është organizatë që drejtohet nga një bord i përkushtuar dhe stafi profesional. Funkcionalizimi i Sekretariatit, si organ menaxhues i Platformës dhe shtrirja e saj jashtë Prishtinës, përmes qendrave rajonale, janë aspektet specifike të zhvillimit të organizatës. Përveç kësaj, CiviKos ka projekte afatgjata që sigurojnë kushte për qëndrueshmërinë financiare të organizatës dhe një sistem të menaxhimit që paraqet bazë të mirë për transparencë dhe llogaridhënie. Vet mënyra e organizimit të Platformës CiviKos hap mundësi për sigurimin e fondeve, pasi bëhet fjalë për një rrjet që përfaqëson një numër të konsiderueshëm të organizatave të shoqërisë civile karshi Qeverisë.

Megjithatë, një mangësi serioze e CiviKos është varësia e tepruar e funksionimit ditor të Platformës nga Bordi, përkundër faktit se punohet shumë në bartjen e autorizimeve drejt Sekretariatit. Pa dyshim, kjo bartje e autorizimeve duhet të shoqërohet edhe me aplikimin e një sistemi të procedurave administrative që siguron llogaridhënie. CiviKos nuk e shfrytëzon sa duhet kapacitetin e organizatave

anëtare për të kryer misionin e vet dhe as për të siguruar fonde. Kjo mund të jetë edhe pasojë e vet karakterit të Platformës, e cila nuk preferohet të garojë për fonde me organizatat anëtare, por kjo nuk

**Sfidat kryesore:**

- Procedurat administrative që sigurojnë llogaridhënie karshi anëtarësisë
- Mundësitë e kufizuara për të aplikuar për fonde
- Qëndrueshmëria e rrjetit të qendrave rajonale

do të thotë se nuk ka hapësirë për aplikime të përbashkëta, atëherë kur ky është interes i përbashkët i një grupi të organizatave anëtare dhe Platformës.

Mundësitë e CiviKos për të siguruar fonde operative janë shumë të kufizuara, për faktin se kuota e anëtarësisë është relativisht modeste, ndërsaq donatorët nuk tregojnë disponim të veçantë për të mbështetur shpenzimet e kësaj natyre. Një skenar i mungesës së fondeve

operative mund ta rrezikojë funksionimin e Sekretariatit të CiviKos.

### 3.3.2. Anëtarësia në CiviKos

Vitet e fundit vërehet trendi i rritjes së organizatave anëtare të Platformës CiviKos, numri i të cilëve ka arritur në 207. Kjo rritje ka ndikuar në forcimin e pozicionit të Platformës karshi Qeverisë dhe komunitetit të donatorëve. Përveç që përfaqëson interesat e anëtarësisë së vet karshi Qeverisë, CiviKos është shndërruar në burim primar të informacionit për grante dhe proceset e politikëbërjes. Vetëm gjatë vitit 2016 janë shpërndarë rreth 126 dokumente qeveritare për konsultim publik, buletine të rregullta të aktiviteteve të CiviKos si dhe informata relevante për shoqërinë civile. Angazhimi i tillë ka bërë që raportet në mes të Sekretariatit dhe të organizatave anëtare të jenë mjaft të avancuara.

**Sfidat kryesore:**

- Kontributi i organizatave anëtare në punën e CiviKos
- Shërbimet për organizatat anëtare
- Bashkëpunimi në mes organizatave anëtare
- Zbatimi i Kodit Etik

Edhe tek organizatat e shoqërisë civile që nuk janë anëtare të Platformës CiviKos ekziston një perceptim pozitiv për platformën, gjë që hap mundësitë për bashkëpunim dhe partneritet me organizata dhe rrjete të tjera.

Megjithatë, është vërejtur se kontributi i organizatave anëtare në punën e CiviKos nuk është në nivelin e kënaqshëm dhe kjo vlen për një numër të madh të këtyre organizatave. Përveç arsyeve që janë jashtë kontrollit të Platformës, një arsye për qasje të tillë mund të jetë promovimi i pamjaftueshëm i punës së organizatave anëtare nga Platforma, si dhe komunikimi sipërfaqësor me anëtarësinë. Pa dyshim, organizatat anëtare presin shërbime të rregullta dhe të strukturuar mirë nga Platforma. Nga ana tjetër, në prill të vitit 2014 Kuvendi i Platformës CiviKos ka aprovuar Kodin Etik i cili duhet të shërbejë si bazë për bashkëpunimin e ndërsjellë në mes të organizatave anëtare. Ky dokument paraqet disa kërkesa që kanë të bëjnë me transparencën, e të cilat një numër i organizatave anëtare nuk janë të gatshme t'i përmbushin.

Në raste të caktuara, organizatat anëtare kanë pritje joreale në raport me Bordin dhe Sekretariatit e Platformës. Më konkretisht, ka raste kur organizatat anëtare presin që këto organe të vihen në mbrojtje të kauzave të tyre, edhe atëherë kur ato mund të jenë kundërthënëse dhe në kundërshtim me pozicionet e organizatave të tjera anëtare. Përfshirja eventuale e Platformës në situata të tilla mund të shkaktojë polarizime të panevojshme në mes të organizatave anëtare, madje edhe largim të ndonjë organizate nga Platforma. Përkundër faktit se numri i anëtarëve është një masë e kredibilitetit të Platformës CiviKos, rritja e pakontrolluar e këtij numri mund të çojë në formalizëm dhe pamundësi të Sekretariatit që, me resurset ekzistuese, të ofrojë shërbime cilësore. Përvoja e deritanishme ka treguar se një rritje e pakontrolluar mund të vështirësojë edhe funksionimin e Kuvendit dhe CiviKos si organi më i lartë drejtues.

### 3.3.3. Bashkëpunimi me autoritetet publike

Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, e cila, më vonë është konkretizuar me Rregulloren për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik dhe Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, paraqet një ndër të arriturat më të mëdha të Platformës CiviKos. Platforma bashkëkryeson Këshillin për zbatimin e kësaj strategjie që i jep një pozicion të mirë për të ndikuar që strategjia të zbatohet, në vazhdimësi, në dokumente dhe veprime konkrete, edhe pse shpesh ka pjesëmarrje të ulët organizatave anëtare në takime. CiviKos ka bashkëpunim të vazhdueshëm strukturor dhe konstruktiv me ZQM/ZKM, ndërsa një rezultat i këtij bashkëpunimi është publikimi i raportit të parë për ndarjen e fondeve qeveritare për organizatat e shoqërisë civile në fillim të viti 2017.

Ekzistojnë mundësi për rritjen e bashkëpunimit në mes të Platformës CiviKos dhe Qeverisë, duke e shfrytëzuar bazën ekzistuese ligjore për bashkëpunim, por edhe duke punuar në drejtim të hartimit të një strategjie të re dhe më të avancuar të bashkëpunimit. Po ashtu, mund të shqyrtohen edhe mundësitë për bashkëpunim me autoritetet e nivelit lokal.

#### Sfidat kryesore:

- Zbatimi i Strategjisë së bashkëpunimit Qeveri-shoqëri civile
- Bashkëpunimi me dikasteret specifike qeveritare dhe Kuvendin
- Bashkëpunimi me autoritetet lokale
- Avokimi tek institucionet publike

Platforma CiviKos nuk është e kënaqur me dinamikën e zbatimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe konsideron se vonesat në zbatim, përveç tjerash, janë rezultat i presionit të pamjaftueshëm nga vet shoqëria civile. Përkundrazi bashkëpunimin e mirë me ZQM/ZKM dhe disa sektorë qeveritarë, Platforma nuk ka arritur deri tani të vendosë një bashkëpunim cilësor edhe me dikasteret specifike brenda Qeverisë, e aq më pak me autoritetet lokale. Ndërkaq, pjesëmarrja jo e kënaqshme e organizatave anëtare në debate publike dhe procese të konsultimit publik është shkaktar evident i defekteve në bashkëpunim me Qeverinë. Një mangësi tjetër e CiviKosit është mungesa e një strategjie për avokim tek institucionet publike.

Vonesa në zbatimin e Strategjisë ose zbatim jokonsekuent të saj mund të ketë edhe në të ardhmen si pasojë e situatës politike jostabile në vend dhe rënies së interesimit të organizatave të shoqërisë civile

për të qenë pjesë e procesit të bashkëpunimit me Qeverinë. Në këtë ndikon edhe mungesa e resurseve humane dhe financiare për mobilizim të organizatave të shoqërisë civile për pjesëmarrje më aktive në procesin e bashkëpunimit.

### 3.3.4. Marrëdhëniet me publikun

Platforma CiviKos mban një web faqe e cila përditësohet me rregull dhe shërben si kanal komunikimi me anëtarësinë dhe me publikun e gjerë. Po ashtu, ka prezencë të shtuar në rrjete sociale dhe në media. Me shembullin e vet dhe përmes Kodit të Etikës, Platforma bën ndikim tek organizatat anëtare që ta shtojnë transparencën financiare karshi publikut, në veçanti në lidhje me financimin nga fondet publike.

Përkundër faktit se CiviKos nuk ka reputacion të keq në media, kjo nuk do të thotë se ka arritur ta zgjojë interesimin e publikut për punën e vet dhe të organizatave anëtare. Në radhë të parë CiviKos nuk ka staf të specializuar për marrëdhënie me publikun, prandaj nuk e promovon sa duhet punën e vet dhe të organizatave anëtare. CiviKosit i mungon një “branding” që do ta bënte lehtësisht të dallueshëm në komunikim me publikun.

Mungesa e vazhdueshme e burimeve njerëzore dhe financiare për marrëdhënie me publikun mund të rezultojë me rënien e interesimit mediatik për punën e CiviKos dhe të organizatave anëtare që, në afat të gjatë, ka për efekt rënien e kredibilitetit të shoqërisë civile në sytë e qytetarëve.

#### Sfidat kryesore:

- Perceptimi publik për organizatat e shoqërisë civile
- Interesimi i mediave për punën e CiviKos
- Kapaciteti për komunikim me publikun

## 4. Vizioni dhe misioni

Platforma CiviKos ka pasur të definuar vizionin dhe misionin e saj, ndërsa procesi aktual i planifikimit ka qenë një rast i mirë që dy përcaktimet më madhore të saj të rishikohen. Anëtarët e Grupit për Planifikim e kanë pa të arsyeshme që të bëhen disa ndryshime në vizionin dhe misionin e Platformës për të reflektuar më mirë aktualitetin, si dhe veprimtarinë e Platformës.

Platforma CiviKos është krijuar me idenë që të jetë lehtësuese e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e ndërtimit të shtetit demokratik. Për këtë arsye, Platforma synon që Kosova të jetë shoqëri e

### VIZIONI

Kosova, shoqëri e vlerave demokratike e udhëhequr nga parimet e transparencës, integritetit, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes.

vlerave demokratike, ndërsa vlerat nga të cilat udhëhiqet një shoqëri e tillë janë transparenca, integriteti, llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja. Ky është edhe vizioni i CiviKos që pasqyron atë që anëtarësia e saj dëshiron ta shoh në mjedisin ku vepron. Një vizion i tillë është në përputhje me kuptimit e ekzistimit të organizatave të shoqërisë

civile, të cilat, në çdo shoqëri demokratike, përfaqësojnë interesat e grupeve të caktuara shoqërore për një qeverisje të mirë

Ndërkaq, misioni i CiviKos është obligimi që merr Platforma për arritjen e vizionit, e të cilin do ta realizojë përmes ekspertizës dhe përkushtimit të vet. Misioni paraqet arsyen e ekzistimit të Platformës CiviKos dhe të gjitha aktivitetet e saj duhet të orientohen drejt përmbushjes së tij. Si edhe deri tani, Platforma do të vazhdojë të jetë lehtësuesi për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në politikë bërje. Bashkë me organizatat anëtare dhe, në bashkëpunim me Qeverinë, Platforma o të synojë krijimin e një mjedisi sa më të favorshëm për bashkëpunim në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike.

### MISIONI

Mobilizimi i potencialit të organizatave të shoqërisë civile për krijimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike


Angazhimin e përditshëm të CiviKos e përshkruan më së miri motoja e Platformës:

**“Qytetari aktive në shërbim të zhvillimit të gjithmbarshëm shoqëror.”**

## 5. Objektivat strategjike

Në procesin e planifikimit janë identifikuar katër objektiva strategjike për periudhën 2018-2022 të dhëna në figurën 2.

**Figura 2.** Objektivat strategjike për periudhën 2018-2022



Këto objektiva janë rruga që ka zgjedhur Platforma CiviKos për përmbushjen e misionit të saj. Hapi i parë dhe i domosdoshëm në këtë drejtim është avancimi i menaxhimit të Platformës, duke bërë ndarje të qartë të autorizimeve në mes të Kuvendit, Bordit dhe drejtorit ekzekutiv, e në funksion të rritjes së efektshmërisë së punës (objektivi 1). Kjo do të krijojë kushte që të ngrihet cilësia e shërbimeve ndaj organizatave anëtare dhe të bëhet mobilizimi i tyre (objektivi 2). Avancimi i dialogut me autoritetet publike dhe shtrirja e tij në nivelin lokal (objektivi 3) është kontribut i drejtpërdrejtë krijimit të një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Ndërkaq, promovimi më i mirë i punës së CiviKos dhe organizatave anëtare (objektivi 4) bën që të shtohet mbështetja për punën që bën shoqëria civile dhe për pozicionim më të mirë karshi autoriteteve publike. Në vazhdim është dhënë përshkrimi i detajuar për secilin nga katër objektivat strategjike.

### Objektivi Strategjik 1: Menaxhim efektiv, transparent dhe llogaridhënës


Menaxhimi efektiv, transparent dhe llogaridhënës është parakusht i rëndësishëm për mirëfunksionimin e një organizate e cila ekziston për t'i shërbyer anëtarësisë së vet. Qeverisja e organizatës e cila ushtrohet nga bordi i saj duhet të jetë e ndarë nga menaxhimi që është detyrë e drejtorit ekzekutiv, por, njëkohësisht duhet të ekzistojnë edhe mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të punës së drejtorit ekzekutiv nga ana e Bordit. Një dekadë pas themelimit të saj, Platforma CiviKos është e përcaktuar që një ndarje e tillë e autorizimeve të jetë shtohet, prandaj edhe do të punohet në ndërtimin e mekanizmave që sigurojnë efektivitet, transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e organizatës.

Për ta adresuar këtë nevojë është e domosdoshme që të punohet në avancimin e procedurave që ka Platforma CiviKos dhe përplotësimin e tyre me procedura të reja që avancojnë funksionimin e



Platformës. Krahas kësaj, duhet punuar në ndërtimin e kapaciteteve njerëzore dhe materiale për menaxhim të mirë, duke avancuar në shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Qasja pro-aktive për sigurimin e fondeve i kontribuon drejtpërdrejt qëndrueshmërisë së Platformës, ndërsa shtrirja e saj në të gjitha rajonet e Kosovës i kontribuon zgjerimit të veprimtarisë dhe ndikimit të platformës në nivelin lokal.

Në vijim është dhënë një përmbledhje skematike e ndërlidhjes në mes të sfidave, aktiviteteve dhe objektivit strategjik.



### Objektivi:

*Menaxhim efektiv, transparent dhe llogaridhënës i Platformës Civikos.*

### Aktivitetet:

#### 1.1. Avancimi i procedurave ekzistuese dhe zhvillimi i procedurave të reja

Me qëllim të bartjes graduale të përgjegjësi menaxheriale nga Bordi tek Sekretariati është e domosdoshme që të punohet në krijimin e procedurave që sigurojnë transparencë dhe

llogaridhënie. Si hap i parë do të bëhet rishikimi i procedurave ekzistuese siç janë: Rregullorja e Bordit të CiviKos, Manuali i Rregullave për Sekretariatën e Platformës CiviKos, e të tjera. Synimi do të jetë që këto procedura t'i përshtaten nevojave të Platformës dhe të jenë në përputhje me praktikën më të mirë të menaxhimit të organizatave të kësaj natyre.

Përveç kësaj, do të analizohet nevoja për hartimin e procedurave të reja që vendosin një sistem të mirëfilltë të menaxhimit në Platformë. Një e tillë mund të jetë Procedura për punësimin e personelit, e cila përcakton hapat e rekrutimit, duke filluar nga përcaktimi i nevojës për një vend pune deri tek nënshkrimi i kontratës së punës. Procedurë tjetër që konsiderohet e nevojshme është Procedura për vlerësimin e performancës së stafit, ku përfshihet edhe vlerësimi i performancës së drejtorit ekzekutiv nga Bordi, pastaj Procedura për menaxhimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, e të tjera.

Rishikimi i procedurave përkatëse dhe hartimi i procedurave të reja do të organizohet nga Bordi dhe Sekretariati, ndërsa, sipas nevojës, do të kërkohet edhe ekspertizë nga jashtë. Monitorim të implementimit të procedurave të reja do të ketë gjatë viteve në vijim, ndërsa sipas nevojës, do të bëhen përmirësime dhe plotësime të mëtutjeshme të tyre.

### *1.2. Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të organizatës*

Elementi qenësor i ngritjes së kapaciteteve menaxhuese të një organizate komplekse siç është CiviKos është ndërtimi i kapaciteteve të stafit që mund të realizohet përmes trajnimeve, pjesëmarrjes në konferenca, udhëtimeve studimore dhe në shumë forma të tjera. Kjo duhet të jetë pjesë e procesit të vlerësimit të performancës dhe planifikimit vjetor të CiviKos. Gjithashtu, ekziston nevoja që stafi të profilizohet për të siguruar një shkallë më të lartë të profesionalizimit gjatë kryerjes së detyrave. Meqë CiviKos operon me numër të vogël të anëtarëve të stafit dhe duhet t'i përgjigjet kërkesave në rritje të anëtarësisë, atëherë duhet të mbështetet në praktikantë të cilët mund të angazhohen për kohëzgjatje deri në 12 muaj. Manuali ekzistues për praktikën profesionale paraqet një bazë të mirë për vazhdimin e angazhimit të praktikantëve, në përputhje me nevojat e Platformës.

Një aspekt tjetër i kapaciteteve menaxhuese të organizatës është shfrytëzimi i teknologjisë për të lehtësuar menaxhimin, komunikimin dhe ofrimin e shërbimeve ose të informacionit. Në këtë drejtim, CiviKos do të analizojë mundësinë për shfrytëzimin e platformave digjitale që bëjnë të mundur një organizim më të mirë të punës dhe të menaxhimit të dokumentacionit, ku bëjnë pjesë: Dropbox, Google Drive, softuerët për menaxhim të dokumentacionit, e të tjera.

Gjithsesi, kapacitetet menaxhuese të CiviKos varen edhe nga përkushtimi dhe ndihma e organizatave anëtare, prandaj do të kërkohen rruga që ato ta mbështesin punën e CiviKos me potencialet e veta.

### *1.3. Qasje pro-aktive për sigurimin e fondeve*

Për shkak të rrethanave objektive, Platforma CiviKos nuk mund të operojë vetëm në bazë të fondeve që mblidhen nga kuota e anëtarësisë e as nga fondet që fitohen nga donatorët, përmes procedurave

garuese. Për më tepër, pjesëmarrja në ftesa të hapura për aplikime mund të bie ndesh me interesat e një grupi të anëtarëve të CiviKos, prandaj Platforma ka nevojë për një politikë që përcakton mundësitë për të aplikuar në raste të tilla, qoftë në partneritet me ndonjë organizatë anëtare apo si entitet i pavarur.

Për shkaqet e lartpërmendura, gjykohet se në strategjinë e vet për sigurimin e fondeve, Platforma CiviKos duhet t'i jep përparësi qasjes proaktive që nënkupton komunikimin e drejtpërdrejtë me donatorë, qoftë në baza bilaterale apo me grupe donatorësh që tregojnë interesim për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Kjo mund të arrihet edhe përmes përfshirjes aktive në procesin e planifikimit të fondeve të donatorëve.

#### 1.4. Shtrirja e veprimtarisë së CiviKos në rajone

Për të mbajtur lidhjet më të mira me organizatat anëtare anekënd Kosovës dhe për të lehtësuar bashkëpunimin e shoqërisë civile me autoritetet lokale, CiviKos do të vazhdojë ta mbajë rrjetin e qendrave rajonale, duke e zgjeruar atë edhe në ato rajone ku nuk ka prani. Gjatë periudhës vijuese do të përcaktohen me saktësi detyrat e qendrave rajonale me pritje që ato të ndihmojnë në mobilizimin e organizatave anëtare nga rajonet përkatëse për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim.

Do të punohet edhe në ndërtimin e kapaciteteve të qendrave rajonale që të ofrojnë informacione relevante për anëtarësinë e CiviKos anekënd Kosovës. Në kuadër të kësaj do të inkurajohet komunikimi dhe rrjetëzimi në mes të qendrave rajonale, në mënyrë që të mësojnë nga përvoja e njëra-tjetrës. Sekretariati i CiviKos do të monitorojë në vazhdimësi punën e qendrave rajonale, duke ndërhyrë për të bërë përmirësime sa herë që kjo është e nevojshme.


#### **Treguesit e suksesit:**

- Deri në vitin 2020, procedurat dhe rregulloret e suksesit marrin vlerësim pozitiv nga organizatat anëtare.  
Burimi: Vlerësimi i Kuvendit të CiviKos.
- Deri në fund të vitit 2018 Sekretariati i CiviKos ka kapacitet të mjaftueshëm për zbatimin e Strategjisë.  
Burimi: Vlerësimi i Bordit të CiviKos.
- CiviKos siguron fonde vjetore të mjaftueshme për veprimtarinë e vet, në lartësi minimale prej 100,000 EUR.  
Burimi: Raportet vjetore të auditimit.
- Deri në fund të vitit 2020, Platforma CiviKos ka 6 qendra rajonale në komuna jashtë Prishtinës..  
Burimi: Raportet vjetore të punës.

## Objektivi Strategjik 2: Mobilizim i organizatave anëtare

Platforma CiviKos mund ta përmbushë misionin e vet për lehtësimin e bashkëpunimit në mes të Qeverisë dhe të Shoqërisë Civile vetëm nëse ia del t'i mobilizojë organizatat anëtare që të jenë pjesë e këtij procesi. Përveç ndërtimit të kapaciteteve të vet Platformës, e që përfshihet në objektivin 1, duhet siguruar që organizatat anëtare të kontribuojnë në punën e Platformës, jo vetëm duke qëndruar prapa aktivitetit të saj, por edhe duke ofruar mbështetje konkrete për të. Po ashtu, duhet përcaktuar qartë shërbimet që ofron Platforma për organizatat anëtare, duke përmirësuar në vazhdimësi cilësinë e tyre. Dhe, në fund, mobilizimi i mirëfilltë nuk është i mundur pa një konsolidim të mirëfilltë të anëtarësisë, qoftë duke përcaktuar nivele të ndryshme të pjesëmarrjes në aktivitetet e bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile ose duke ndihmuar organizatat anëtare që t'i përmbushin kërkesat që shtron para tyre vet anëtarësia në Platformën CiviKos.

Në vijim është dhënë një përmbledhje skematike e ndërlidhjes në mes të sfidave, aktiviteteve dhe objektivit strategjik.



### Objektivi:

*Mobilizim i organizatave anëtare përmes ndërveprimit të vazhdueshëm dhe ofrimit të shërbimeve cilësore.*

## **Aktivitetet:**

### *2.1. Ofrimi i shërbimeve për organizatat anëtare*

Platforma Civikos do të bëjë konsultime me organizatat anëtare për të përcaktuar një portofolio të shërbimeve e cila është në përputhje me pritjet dhe nevojat e tyre. Shërbime të tilla mund të jenë: 1) informimi për mundësitë e pjesëmarrjes në konsultime publike dhe për çështje të tjera relevante që kanë të bëjnë me organizatat e shoqërisë civile; 2) lehtësimi i përfshirjes së përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm konsultativë të nivelit qendror ose lokal; 3) promovimi i punës së organizatave anëtare; 4) lehtësimi i bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të organizatave anëtare; 5) përmbushja e kërkesave të organizatave anëtare për shërbime që mund t'i ofrojnë organizatat tjera anëtare të Platformës; si dhe shërbime të tjera.

Që të sigurohet cilësia e shërbimeve të ofruara dhe të analizohet nevoja për shërbime të reja, Sekretariati do të bëjë matjen e kënaqshmërisë së organizatave anëtare me shërbime, të paktën një herë brenda vitit. Ndërkaq, për të shmangur pritjet joreale të disa organizatave anëtare për përfshirje në agjenda që janë jashtë misionit të Platformës, Sekretariati duhet të punojë në vazhdimësi për ta sqaruar pozicionin e Platformës.

### *2.2. Sigurimi i kontributit të organizatave anëtare në punën e Platformës Civikos*

Platforma Civikos do të ketë ndërveprim të rregullt me organizatat anëtare. Sipas nevojës, do të organizohen konsultime për çështje me interes për Platformën, si dhe do të bëhet mobilizimi i organizatave anëtare për t'i kontribuar procesit të bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile. Në të gjitha situatat e tilla rol kyç do të kenë qendrat rajonale të Platformës Civikos, të cilat do të bëjnë të mundur një komunikim të rregullt me organizatat anëtare në rajonet përkatëse.

Qëllimi i një ndërveprimi të tillë është që të sigurohet kontributi i organizatave anëtare në punën e Platformës Civikos. Ato organizata mund t'i kontribuojnë vet zhvillimit të bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile, por edhe ndërtimit të kapacitetit të Platformës (aktiviteti 1.2). Prandaj, do të ishte e arsyeshme të bëhet një "hartëzim" ("mapping") i organizatave anëtare sipas fushave të ekspertizës dhe interesimeve të tyre. Ky proces mund të pasohet nga një diskutim i përqendruar në përfshirjen aktive të këtyre organizatave në punën e Civikos.

Për ndërtimin e një përkushtimi afatgjatë të organizatave anëtare ndaj Platformës Civikos është me rëndësi që tek ato të krijohet një ndjenjë e fuqishme e pronësisë në raport me rezultatet e punës së Civikosit. Sekretariati i Platformës do të ndërtojë një sistem për vlerësimin periodik të pjesëmarrjes dhe kontributit të organizatave anëtare për të qenë në gjendje të punojë drejt shfrytëzimit më të mirë të kapaciteteve të tyre.

### *2.3. Konsolidimi i anëtarësisë së Civikos*

Për organizatat komplekse siç është Platforma Civikos është me rëndësi që anëtarësia të jetë e mobilizuar dhe të jetë e qartë se çfarë lloj kontributi mund t'i ofrojë Platformës. Jo të gjitha

organizatat anëtare kanë interesa dhe mundësi të njëjta për të marrë pjesë në rrjetëzimin e lehtësuar nga Platforma CiviKos, prandaj shihet e arsyeshme të hapet një diskutim për shkallëzimin e organizatave anëtare në bazë të kriterëve të përcaktuara. Kjo nënkupton përcaktimin eventuale të disa niveleve të pjesëmarrjes së anëtarëve në punën e Platformës CiviKos, ashtu që secila organizatë anëtare të jetë në nivelin që i përgjigjet më së miri mundësive dhe interesave të saj.

Një çështje me rëndësi për konsolidimin e anëtarësisë së CiviKos është zbatimi i Kodit Etik nga ana e organizatave anëtare. Informatat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i organizatave anëtare nuk e zbatojnë Kodin Etik, por nuk ka ndonjë analizë më të thellë se pse ndodhë kjo. Për këtë qëllim, Sekretariati do të organizojë një vlerësim të zbatimit të kodit Etik nga organizatat anëtare, duke nxjerrë përfundime për hapat e më tutjeshëm që mund të nënkuptojnë zbatimin e Statutit aktual të Platformës CiviKos, por edhe bërjen e ndryshimeve eventuale në Statut dhe në vet Kodin Etik. Gjithsesi, disa organizata anëtare mund të kenë nevojë për ndihmë në zbatimin e Kodit.


#### **Treguesit e suksesit:**

- Mbi 50% të organizatave anëtare janë të kënaqur me shërbimet që ofrohen nga CiviKos.  
Burimi: Sondazhi vjetor i anëtarëve i realizuar nga Sekretariati.
- Të paktën 30% e organizatave anëtare kontribuojnë në mënyrë aktive në punën e CiviKos .  
Burimi: Vlerësimi vjetor i Sekretariatit.
- Rritet numri i organizatave anëtare që zbatojnë Kodin Etik: Viti 2018 -20%, Viti 2019: 40%; Viti 2020: 60%, Viti 2021: 80%, Viti 2022: mbi 95%.  
Burimi: Vlerësimet vjetore të Sekretariatit.

### **Objektivi Strategjik 3: Avancimi i dialogut**

Dialogu në mes të autoriteteve publike dhe shoqërisë civile është instrumenti kryesor përmes të cilit realizohet bashkëpunimi i mirëfilltë në mes të këtyre subjekteve. Deri tani, korniza për këtë bashkëpunim ka qenë Strategjia qeveritare për bashkëpunimin me shoqërinë civile 2013-2017, e cila ka rezultuar me vendosjen e një dialogu të vazhdueshëm dhe krijimit të disa mekanizmave për bashkëpunim. Procesi i hartimit të strategjisë së re për periudhën 2018-2022 tanimë ka filluar dhe Platforma CiviKos shihet si një lloj përfaqësuese e interesit të shoqërisë civile në këtë proces. Pas hartimit të Strategjisë së re, përqendrimi i CiviKos do të jetë në lehtësimin e bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile, duke bërë të mundur një përfshirje sa më të gjerë të organizatave të shoqërisë civile, e në përputhje me mundësitë dhe interesat e tyre. Një ndërmarrje e re strategjike është shtrirja e bashkëpunimit me autoritetet publike të nivelit lokal që do të kërkojë mjaft angazhim nga Platforma CiviKos, qendra rajonale dhe organizatat anëtare që punojnë në nivelin lokal.

Në vijim është dhënë një përmbledhje skematike e ndërlidhjes në mes të sfidave, aktiviteteve dhe objektivit strategjik.



### Objektivi:

*Avancimi i dialogut të strukturuar në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike.*

### Aktivitetet:

#### 3.1. Kontributi në procesin e hartimit të strategjisë së re të bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile

Procesi i hartimit të Strategjisë së re të bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile tanimë ka filluar , edhe pse ka ngecur që në fillim për shkak të zgjedhjeve të nivelit qendror dhe lokal. Sidoqoftë, CiviKos do të jetë faktor i rëndësishëm në procesin e hartimit të Strategjisë së re. Hapi i parë që Platforma planifikon ta ndërmerret është vlerësimi i zbatimit të Strategjisë aktuale, proces i cili tanimë ndodhet në stadin e avancuar të zbatimit. Pastaj, në kuadër të procesit të hartimit të Strategjisë së re, CiviKos do të lehtësojë konsultimin me organizatat e shoqërisë civile, duke kërkuar dhe sistemuar kontributin e tyre për këtë dokument.

Platforma CiviKos do të vazhdojë të insistojë që pjesë e strategjisë të jenë temat me interes për organizatat e shoqërisë civile siç janë: pjesëmarrja në politikëbërje, kontraktimi i shërbimeve, financimi i shoqërisë civile nga fondet publike, promovimi i vullnetarizmit, etj. Për të gjitha këto tema do të zhvillohen diskutime me anëtarësinë e Platformës dhe do të barten qëndrimet tek

hartuesit e Strategjisë. Po ashtu, Platforma CiviKos do të vendosë komunikim me Zyrën për Planifikim Strategjik të ZKM në mënyrë që të sigurohet se ndiqen hapat e përcaktuar për zhvillimin e dokumenteve strategjike dhe se Strategjia në të cilën po punohet është në harmoni të plotë me dokumentet tjera zhvillimore të Republikës së Kosovës.

### *3.2. Lehtësimi i bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile*

Bashkëpunimi Qeveri-Shoqëri Civile mbështetet në strategjinë përkatëse dhe disa dokumente të tjera që dalin nga ajo Strategji, siç janë: Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik dhe Rregullorja mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Platforma CiviKos do të zhvillojë veprime të ndryshme për të lehtësuar bashkëpunimin Qeveri-Shoqëri Civile. Si hap i parë është shpërndarja e informacionit për këto dokumente dhe dokumente të tjera relevante tek organizatat e shoqërisë civile, në mënyrë që të maksimizohet përfitimi i tyre nga mundësitë ekzistuese.

Përveç kësaj, Platforma do të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të Strategjisë dhe të dokumenteve përcjellëse. Për këtë qëllim, Platforma do të ndërtojë një sistem të mirëfilltë monitorimi, të cilin do ta përmirësojë me kalimin e kohës. Po ashtu, do të publikohen raportet e monitorimit të paktën një herë në vit, si dhe storie të suksesit për bashkëpunimin Qeveri-Shoqëri Civile të cilat mund të shërbejnë për planifikimin më të mirë në të ardhmen. Në bazë të praktikave të deritanishme, Platforma do të përfshihet në trupat për zbatimin e Strategjisë dhe do të lehtësojë pjesëmarrjen e organizatave të tjera të shoqërisë civile në ato trupa. Me këtë rast, do të insistohet që të rishikohen procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në këto trupa, në mënyrë që të sigurohet një përfaqësim sa më i mirë.

Shtrirja e bashkëpunimit të Platformës CiviKos me dikasteret specifike qeveritare është një detyrë tjetër që shtrohet para organizatës në të ardhmen. Kjo mund të realizohet me ndihmën e organizatave anëtare që punojnë në fusha të caktuara dhe mund të kontribuojnë që bashkëpunimi në ato fusha të jetë sa më cilësor.

### *3.3. Lehtësimi i bashkëpunimit të shoqërisë civile me autoritetet lokale*

Shtrirja e bashkëpunimit Autoritete publike-Shoqëri Civile në nivelin lokal është një ndër përcaktimet strategjike të CiviKos-it, pasi kështu ndikohet drejtpërdrejt në demokratizimin e qeverisjes në nivelin lokal. Për këtë qëllim, CiviKos do të avokojë që të zhvillohen standardet e konsultimit publik në nivelin lokal, në mënyrë të ngjashme si janë zhvilluar në nivelin qendror.

Platforma CiviKos do të hartojë një kornizë për bashkëpunimin në mes të autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile dhe do të punojë në ndërtimin e kapacitetit të organizatave të shoqërisë civile për zbatimin e saj. Në këtë aspekt, është me rëndësi të veçantë që të bëhet mobilizimi i organizatave anëtare në komuna, që përfshin një aktivitet më të madh të Platformës përmes qendrave rajonale.

Komunikimi i rregullt me Ministrinë e Administrimit dhe të Pushtetit Lokal (MAPL) mund të ndihmojë për nxitjen e komunave që të bashkëpunojnë me shoqërinë civile. Ndërkaq, që ky



bashkëpunim të jetë i qëndrueshëm dhe të thellohet në vazhdimësi nevojitet që të bëhet një lloj monitorimi i zbatimit të kornizës për bashkëpunim.

**Treguesit e suksesit:**


- Bordi i CiviKos jep vlerësim pozitiv për procesin e hartimit të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2018-2022, si dhe për vet dokumentin e Strategjisë.  
Burimi: Vlerësimi përkatës i Bordit.
- Niveli i zbatimit të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2018-2022 është të paktën 70% në vit, me trend të rritjes.  
Burimi: Raportet vjetore të monitorimit nga CiviKos, sipas metodologjisë ekzistuese.
- Deri në vitin 2022, në të paktën 50% të komunave të Kosovës, shoqëria civile e shfrytëzon kornizën e bashkëpunimit me autoritetet lokale.  
Burimi: Raportet vjetore të monitorimit nga CiviKos.

**Objektivi Strategjik 4: Promovimi i punës**

Pavarësisht se sa efektive është puna brenda një organizate, ajo nuk bën ndikimin e dëshiruar, nëse palët me interes dhe publiku i gjerë nuk kanë informacion për sukseset dhe kontributet e organizatës. Kjo është arsyeja e përfshirjes së promovimit në planin strategjik të Platformës CiviKos. Në këtë formë, informohen palët me interes dhe publiku i gjerë për kontributin e Platformës dhe anëtarësisë së saj, rritet reputacioni i Platformës në sytë e publikut, si dhe krijohen mundësi për të siguruar fonde të reja.

Përqendrimi do të jetë tek qasja më profesionale ndaj promovimit të punës së Platformës CiviKos dhe anëtarëve të saj në mënyrë që mesazhet e duhura të përcillen në adresat e duhura dhe të bëjnë efektin e dëshiruar.

Në vijim është dhënë një përmbledhje skematike e ndërlidhjes në mes të sfidave, aktiviteteve dhe objektivit strategjik.



## **Objektivi:**

*Promovimi cilësor i punës dhe rezultateve të CiviKos dhe organizatave anëtare.*

## **Aktivitetet:**

### *4.1. Angazhimi i një zyrtari për komunikim me anëtarët dhe publikun*

Shpërndarja e informatave brenda dhe jashtë Platformës CiviKos, menaxhimi i rrjeteve sociale dhe ueb faqes, organizimi i ngjarjeve të ndryshme dhe përgatitja e materialeve promovuese janë aktivitete që kërkojnë një investim mjaft të madh të kohës, dhe arrihen, më së lehti, me angazhimin e një personi përgjegjës që do të merret me këto detyra, me orar të plotë në baza ditore. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij personi janë:

- Mbledhja dhe shpërndarja e informacioneve brenda dhe jashtë CiviKos,
- Dokumentimi i të gjitha aktiviteteve të CiviKos,
- Menaxhimi i rrjeteve sociale dhe ueb faqes,
- Hartimi i planit të komunikimit në baza vjetore,
- Organizimi i ngjarjeve të ndryshme të CiviKos,
- Monitorimi i rregullt i mediave,
- Promovimi i punës së organizatave anëtare të CiviKos,
- Përgatitja e materialeve promovuese dhe kontraktimi i burimeve të jashtme për shërbime sipas nevojës,
- Krijimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me media, donatorë, të gjitha palët me interes dhe publikun e gjerë

Nëse CiviKos nuk gjen mënyrë për të alokuar buxhet për një person i cili, në baza ditore dhe me orar të plotë, do të jetë përgjegjës për komunikim, atëherë do të paraqitet nevoja e angazhimit shtesë e të stafit ekzistues për të kontribuar në informimin dhe promovimin cilësor të Platformës, shoqëruar me rekrutimin e eventual të një praktikanti/eje.

### *4.2. Krijimi i “brandingut” të CiviKos*

Të gjitha dokumentet dhe informacionet që dërgohen tek publiku i gjerë duhet të kenë një pamje të qëndrueshme, dhe secili material promovues duhet të ndjekë një format të caktuar. Nevoja për brendim dhe hartimin e rregullave për visibilitet shfaqet edhe si kërkesë e donatorëve, të cilët kërkojnë pajtueshmëri me kriteret e tyre të visibilitetit. Brendimi dhe hartimi i rregullave për visibilitet arrihet me krijimin e një Brand Book (Libri i organizatës).

Ky libër shpesh i referuar edhe si “udhëzuesi për standardet dhe imazhin e brendit” është një libër i përbërë nga një grup rregullash që shpjegojnë se si duhet të funksionojë organizata kur bëhet fjalë për promovimin e saj dhe si duhet krijuar identiteti i qëndrueshëm i saj. Këto udhëzime, zakonisht, përfshijnë:

- Specifikimet për përdorimin e logos (shembuj vizual të përdorimeve të sakta dhe të pasakta të logos),
- Paleta e ngjyrave që duhet përdorur si dhe lloji i tipografisë,
- Llojin e fotografive,
- Mbështetjen e elementeve grafike,
- Disejnimin dhe specifikimet për të gjitha materialet promovuese,
- Udhëzimet për faqen e profilit për të gjitha rrjetet sociale,
- Udhëzime për ueb faqe,
- Udhëzimet për lloje të tjera të promovimit.

Një brendim i mirë ndihmon në pozicionimin e një organizatë në nivel të dëshiruar në fushën e saj të shërbimit. Libri i organizatës duhet hartuar nga një dizajner grafik profesional apo nga ndonjë agjenci e marketingut.

#### 4.3. Informimi i publikut për punën e Civikos dhe organizatave anëtare

Informimi i drejtë nënkupton që çdo mesazh të përpilohet në mënyrë që ta tërheq publikun të cilin e synojmë. Secilit grup duhet ti kushtohet vëmendje individuale që implikon një vëllim më të madh të punës në fushën e informimit. Tabela 1 paraqet disa shembuj se si mesazhet mund të jenë të përshtatura për audiencë të ndryshme.

**Tabela 1.** Mesazhet e përshtatura për audiencë të ndryshme

<b>Publiku i synuar</b>	<b>Çfarë duhet të dinë ata?</b>
Donatorët	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sukseset e organizatës ndër vite</li> <li>• Organizata është e besueshme dhe transparente</li> </ul>
Përfituesit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë ofron organizata për ta?</li> <li>• Si të kenë qasje në shërbimet e organizatës?</li> <li>• Ku të drejtohen për këshilla?</li> <li>• Organizata ofron informata praktike të dobishme si dhe mbështetje të plotë</li> <li>• Organizata vë në qendër nevojat e përfituesve dhe i vlerëson mendimet e tyre</li> </ul>
Përfaqësues qeveritarë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizata është e gatshme dhe ka aftësi për të sjellë ndryshime</li> <li>• Organizata është e gatshme për bashkëpunim.</li> <li>• Organizata gëzon respekt.</li> </ul>
Organizata tjera vendore dhe rajonale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizata është e gatshme për të ofruar ekspertizë në fushat të cilat është e përfshirë.</li> <li>• Organizata është e gatshme për shkëmbim të përvojave të mira me organizata të tjera.</li> <li>• Organizata është e gatshme për bashkëpunim dhe partneritet.</li> </ul>
Mediat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Storit e suksesit dhe rezultatet që organizata ka sjellë ndër vite</li> <li>• Aktivitetet e organizatës dhe ngjarjet e saj</li> </ul>

**Ueb faqja** është kanali i cili ndikon më së shumti në identitetin e organizatës. OJQ-të që duan të lënë një përshtypje profesionale dhe të rrisin fondet kanë nevojë për një ueb faqe që do të frymëzojë interesim tek të gjithë. Si çdo ueb faqe e suksesshme, edhe kjo duhet të jetë e lehtë për tu naviguar si dhe të ketë një pamje dhe dizajn tërheqës. Strukturimi dhe menaxhimi i mirë i ueb faqes flet shumë për organizatën, prandaj në të duhet të përfshihen të gjitha informatat për organizatën dhe veprimtarinë e saj qysh nga themelimi e deri më sot, si dhe të bëhet rifreskimi i rregullt i saj. Web faqja e CiviKos ([www.civikos.net](http://www.civikos.net)) është mjaft mirë e strukturuar dhe kërkon vetëm disa adaptime më të vogla për te akomoduar më mirë përcaktimin për promovimin e punës së organizatave anëtare.

**Facebook** është një platformë komunikimi e rëndësishme për organizatat jo-qeveritare, prandaj prania aktive në Facebook është thelbësore për të qëndruar në kontakt me mbështetësit, për të ndërtuar një bazë të njerëzve të angazhuar në misionin e organizatës dhe për të përcjellë mesazhe të fuqishme me fotografi të ndryshme dhe me tekst. Duke pasur parasysh se shumica e njerëzve me qasje në internet kanë profilin e tyre në Facebook, organizata duhet t’i jap rëndësi kyçe këtij kanali komunikimi. Një strategji e Facebook-ut është pjesë e pandashme e përpjekjeve të një organizate për promovim cilësor, dhe është e nevojshme për të plotësuar mjete të tjera të komunikimit. Për të rritur numrin e ndjekësve të faqes dhe numrin e pëlqimeve, është i nevojshëm përditësimi aktiv i faqes. Facebook-u është një rrjet social mjaft i lehtë për tu përdorur, megjithatë disa detaje duhet të merren parasysh kur përdoret si medium kyç i komunikimit. Jo çdo storie, apo ngjarje e organizatës mund të jetë tërheqëse dhe relevante për të gjithë ndjekësit. Për këtë, postimet e shpeshta dhe me përmbajtje të tepërt që nuk përçojnë ndonjë mesazh me rëndësi, paraqesin rrezik që të bezdisin ndjekësit e faqes dhe si pasojë i humbim ata. Për këtë arsye duhet treguar kujdes në përmbajtjen dhe numrin e postimeve. Tabela 2 tregon llojin e aktiviteteve të rekomanduara për organizata jo-qeveritare dhe rezultatet që ato sjellin.

**Tabela 2.** Aktivitetet e mundshme në Facebook

<b>Aktiviteti</b>	<b>Si do të realizohet</b>	<b>Rezultati</b>
Komunikim rutinor	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të krijohet një rregull se gjatë cilave ditë dhe orë, si dhe çfarë materiali do të postohet.</li> <li>Nëse aktivitetet janë të shpeshta atëherë koha më e përshtatshme për postim është mëngjesi (fillimi i orarit të punës) kur njerëzit kontrollojnë email-at dhe mediat sociale dhe ora 14 kur të gjithë kthehen nga pushimi i drekës.</li> </ul>	Përmes rregullit të postimeve krijohet edhe një lidhje me ndjekësin të cilët e dinë kur të presin lajme dhe të ndjekin aktivitetet e organizatës në mënyrë rutinore.

Aktiviteti	Si do të realizohet	Rezultati
Jetësimi i postimeve dhe shtimi i alternativave të reja	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyrtari për komunikim apo stafi duhet të sigurohen që secili postim të përcjell një mesazh me rëndësi dhe të tregojë se kush po përfiton nga ky aktivitet.</li> <li>• Për më tepër duhet siguruar që të gjitha postimet të ofrohen edhe në gjuhën shqipe.</li> <li>• Të dokumentohen të gjitha paraqitjet televizive të organizatës, përfshirë këtu edhe paraqitjet individuale të stafit.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shkrimi i postimeve të tilla gjithmonë përfaqëson një tregim dhe jo vetëm një lajm të rëndom. Duke treguar rezultate të aktiviteteve dhe duke përfshirë sa më shumë përfituesit mundësia për zgjerim të aktivitetit në fjalë rritet.</li> <li>2. Përmbajtja e postimeve në të dy gjuhët rrit seriozitetin e organizatës duke mundësuar kështu qasje më të lehtë edhe me partnerët dhe donatorët, për të cilët edhe shpesh flitet në postimet e OJQ-ve.</li> <li>3. Dokumentimi i këtyre ngjarjeve dëshmon punën dhe rëndësinë e organizatës, si dhe përfshirjen e saj në rrjetëzim me organizata të tjera të mëdha.</li> </ol>
Përdorimi i imazheve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Postimi i fotove nga vendi i ngjarjes është i domosdoshëm.</li> <li>• Krijimi i infographics për të prezantuar fakte dhe statistika të projekteve dhe kauzave të CiviKos.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njerëzit tërhiqen dhe bashkëveprojnë më shumë me fotografi dhe video sesa me tekst.</li> </ol>
Krijim i relacioneve të mira me ndjekës të faqes	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizata duhet të sigurohet që të përgjigjet në çdo pyetje të ndjekësve dhe, njëkohësisht, të parashtrojë vet pyetje apo tema për të nxitur diskutim.</li> <li>• Gjithashtu, duhet t'i bëhet "share" praktikave të mira të fushave në të cilat CiviKos është e përfshirë, kryesisht të atyre jashtë vendit.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mediat sociale ekzistojnë për të ofruar sa më shumë përfshirje sociale. Duke nxitur diskutime, dhe duke ofruar përgjigje për ndjekësit e faqes, organizata shndërrohet në një burim të informatave me vlerë, dhe krijon marrëdhënie të afërta me ndjekësit.</li> <li>2. Në këtë mënyrë dëshmohet për interesimin e madh të organizatës për të rekomanduar praktika të mira dhe për të sjellë ndryshim në sektorin në fjalë në Kosovë.</li> </ol>

**LinkedIn** është rrjeti profesional më i madh në botë, që mundëson promovimin e punës dhe krijimin e lidhjeve të reja, dhe forcimin e atyre ekzistuese me të gjitha palët me interes. Aktualisht, rreth 6 milionë anëtarë të organizatave jo-fitimprurëse janë duke përdorur LinkedIn për të ndërtuar

identitetin e tyre dhe rrjetin e mbështetësve. Mirëmbajtja e profilit ekzistues të CiviKos në LinkedIn, me rritjen e numrit të kontakteve, forcon promovimin e punës së CiviKos. Për më tepër, secili anëtar nga personeli i CiviKos me qasje në LinkedIn ka mundësinë ta ndërlidh profilin e tij/saj personal me atë të CiviKos, duke përfshirë kështu pozitat e tyre në organizatë.

### **Mediat ( TV, Portale, Gazeta)**

Përfshirja dhe publiciteti në media është një mjet për të tërhequr e vullnetarët dhe donacionet, por edhe për të inkurajuar angazhimin qytetarëve, dhe për të fituar besimin e publikut të gjerë dhe të partnerëve të mundshëm institucionalë. Për një rrjet siç është CiviKos dhe punën të cilën e bën është e domosdoshme të krijohen raporte të mira me mediat lokale në mënyrë që informata për aktivitetet e saj të transmetohet sa më shumë. Krijimi dhe mbajtja e raporteve të mira me media është një prej detyrave kryesore të zyrtarit për komunikim, i cili duhet të ketë kontakt të vazhdueshëm me media dhe t'i informoj mediat për aktivitete të organizatës të cilat synojnë për hapësirë mediale. Është e rëndësishme që, gjatë një viti, organizata të ketë paraqitje të herë pas herëshme në media të ndryshme dhe t'i transmetoj storiet e saj të suksesit.

Kjo arrihet, kryesisht, përmes komunikatave për shtyp për hartimin dhe shpërndarjen e të cilave është përgjegjës zyrtari për komunikim. Komunikatat për shtyp duhet të hartohen pas çdo storie të suksesit, rezultati apo ngjarje të organizatës dhe të përcillen tek të gjitha mediat. Për të qenë e suksesshme, një komunikatë e mirë duhet të jetë jo shumë e gjatë, e qartë dhe e thjeshtë. Duhet shpjeguar pyetjet Kush? Çka? Kur? Ku? Si? dhe Pse? Njoftimi shkruhet në formën e piramidës së përmbytur – ku paragrafi i parë përmban thelbin e ngjarjes.

**Materialet promovuese** të një organizate përcjellin mesazhe të lëshuara në emër të një ideje, kauze apo të vet organizatës, në forma të ndryshme promovuese. Këto materiale përfshijnë broshura, fletëpalosje, raporte të ndryshme, publikime, posterë, banerë, folderë, fletore, stilolapsa, qese, gota, apo edhe ndonjë formë tjetër që shfaqet e nevojshme në ndërkohë. Pas përgatitjes së tyre, këto materiale mund të shpërndahen në formë të shtypur gjatë ngjarjeve të ndryshme të CiviKos, gjatë pjesëmarrjes së CiviKos në punëtori, trajnime, konferenca vendore dhe ndërkombëtare, si dhe shume prej tyre edhe në formë elektronike tek të gjithë të interesuarit.

**Ngjarjet promovuese** të organizatës luajnë rol të madh në forcimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me të gjitha palët me interes. Këto ngjarje përfshijnë konferenca lansuese dhe përmbyllëse për ndonjë projekt të caktuar dhe një event social për palët me interes në fund të çdo viti. Këto ngjarje duhet përdorur për të ftuar persona me autoritet dhe për të prezantuar punën dhe rezultatet e CiviKos si dhe për të fituar hapësirë mediale.

### **Treguesit e suksesit:**

- Numri i klikimeve në web faqen e CiviKos-it është të paktën 2,000 në muaj me trend të rritjes..  
Burimi: Statistikat e web-it.
- Faqja e CiviKos në Facebook ka të paktën 5000 ndjekës me trend të rritjes.  
Burimi: Statistikat nga Facebook-u.

- Çdo muaj publikohen të paktën dy kontribute mediale për punën e Platformës CiviKos në mediat elektronike dhe të shkruara.  
Burimi: Kontributet mediale.

## 6. Burimet për zbatimin e Strategjisë

Platforma CiviKos, si rrjeti më gjithëpërfshirës dhe më përfaqësues në Kosovë i organizatave joqeveritare, do të duhej të finançohej nga kuota e anëtarësisë dhe kontributet e drejtpërdrejta të donatorëve. Në realitet, kuota e anëtarësisë përbën një burim modest të të hyrave, ndërsa kontributet e donatorëve, në shumë raste, nuk janë të drejtpërdrejta, por duhet të fitohen përmes procedurave garuese.

Sidoqoftë, në bazë të raporteve të auditimit, shpenzimet vjetore të CiviKos vlerësohen në 100,000 – 110,000 EUR, prej të cilave 65-70,000 EUR janë shpenzime administrative dhe për pagat e drejtorit dhe tre punonjësve, ndërsa pjesa tjetër përbën shpenzimet programore. Në procesin e planifikimit strategjik kemi bërë përpjekje që ta vlerësojmë koston programore për periudhën 2018-2022, duke i shtuar edhe koston zhvillimore, me ç’ rast kemi synuar të mbetemi brenda mundësive buxhetore tanimë të dokumentuara.

Kështu, kalkulimet tona tregojnë se një buxhet optimal për shpenzimet vjetore programore të CiviKos, duke i përfshirë edhe disa shpenzime zhvillimore, do të ishte rreth 37,000 EUR. Kjo shumë bashkë me shpenzimet e vlerësuara operative prej 70,000 EUR e mban buxhetin vjetor të organizatës në nivelin e disa viteve të fundit. Vlerësimi i koston për zbatimin e Strategjisë, sipas viteve, është dhënë në tabelën 3.

**Tabela 3.** Buxheti për zbatimin e Strategjisë 2018-2022 (në euro)

Objektivi	Viti					Gjithsej
	2018	2019	2020	2021	2022	
1. Menaxhim efektiv, transparent dhe llogaridhënës i Platformës CiviKos	18,600	16,600	18,800	18,800	18,800	91,600
2. Mobilizim i organizatave anëtare përmes ndërveprimit të vazhdueshëm dhe ofrimit të shërbimeve cilësore	300	-	-	-	-	300
3. Avancimi i dialogut të strukturuar në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike	5,500	2,500	2,500	2,500	2,500	15,500
4. Promovimi cilësor i punës dhe rezultateve të CiviKos dhe organizatave anëtare	13,000	15,500	15,500	15,500	15,500	75,000
	<b>37,400</b>	<b>34,600</b>	<b>36,800</b>	<b>36,800</b>	<b>36,800</b>	<b>182,400</b>

Në vazhdim është dhënë një përshkrim i shkurtër i buxhetit të planifikuar sipas objektivave.

1. Menaxhim efektiv, transparent dhe llogaridhënës. – Përbën gjysmën e koston vjetore të zbatimit të Strategjisë dhe përfshin pagat e dy praktikantëve, si dhe koston vjetore të mbështetjes së 5 qendrave ekzistuese rajonale dhe një qendre të gjashtë, duke filluar nga viti 2020. Në këtë objektiv përfshihet edhe kosto e ekspertizës së nevojshme për zhvillimin e organizatës, si dhe implementimi avancimeve teknologjike që mund të adoptohen ndërkohë. Buxheti për këtë objektiv nuk është më i madh, pasi CiviKos llogaritet në ndihmën e organizatave anëtare për implementimin e disa prioriteteve strategjike, siç është zhvillimi profesional i stafit, këshillimi rreth avancimit të menaxhimit dhe të ngjashme.
2. Mobilizim i organizatave anëtare. – Ky objektiv është, pothuaj se, pa kosto për CiviKosin pasi ndërthet aktivitetet që financohen drejtpërdrejt nga shpenzimet operative të organizatës – pagat dhe shpenzimet administrative. Kjo nuk është e rastit, pasi CiviKos është në funksion të anëtarëve të vet dhe puna e drejtpërdrejtë në organizatat anëtare nuk ka kosto shtesë.
3. Avancimi i dialogut. – Këtu përfshihen shpenzime që kanë të bëjnë me kontributin e CiviKos në hartimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, si dhe shpenzimet e monitorimit dhe promovimit të rezultateve të monitorimit.
4. Promovimi i punës. – Shpenzimet për këtë objektiv përbëjnë diç mbi 40% të koston për implementimin e Strategjisë. Këtu përfshihet paga e një zyrtari për komunikim, me orar të plotë pune, si dhe një shumë vjetore prej 3,500 EUR për shpenzime promovimi: mirëmbajtja e web faqes, materialet promovuese, e të ngjashme.

Ideja është që këto mjete të sigurohen, kryesisht, përmes negocimit të drejtpërdrejtë me donatorët, siç përshkruhet në aktivitetin 1.3 të kësaj Strategjie. Ndërkaq, për zgjerimin e aktiviteteve jashtë kornizave të Strategjisë ose në përmasa që tejkalojnë planifikimin është i nevojshëm sigurimi i fondeve shtesë nga burime të tjera.

## 7. Plani i veprimit

Në vijim është prezantuar një plan veprimi për zbatimin e Strategjisë. Plani është i ndarë sipas objektivave strategjike dhe aktiviteteve përkatëse. Secili aktivitet është zbërthyer në një varg veprimesh që duhet të ndërmerren dhe është përcaktuar përgjegjësia dhe korniza kohore për zbatimin e secilit veprim. Vet zbërthimi i aktiviteteve në veprime është bërë në bazë të përshkrimeve të aktiviteteve të dhëna në kapitullin 5, prandaj edhe, për çdo paqartësi, duhet të konsultohen këto përshkrime.

Ky plan veprimi duhet të shihet si tentativë për ta konkretizuar një planifikim strategjik 5-vjeçar. Megjithatë, është e nevojshme që plani i veprimit të përcaktohet në baza vjetore, duke marrë parasysh shkallën e implementimit të Strategjisë në vitin paraprak dhe mundësitë për vitin vijues.



**Objektivi 1:** Menaxhim efektiv, transparent dhe llogaridhënës i Platformës CiviKos

<b>Aktiviteti 1.1</b> Avancimi i procedurave ekzistuese dhe zhvillimi i procedurave të reja							
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit				
			2018	2019	2020	2021	2022
1.1.1	Marrja e vendimit për rishikimin e procedurave ekzistuese dhe zhvillimin e procedurave të reja	Bordi	x				
1.1.2	Rishikimi i procedurave ekzistuese të CiviKos	Sekretariati	x				
1.1.3	Zhvillimi i procedurave të reja	Sekretariati	x				
1.1.4	Aprovimi i procedurave	Bordi	x				
1.1.5	Monitorimi dhe rishikimi eventual i procedurave	Sekretariati Bordi			x		x
<b>Aktiviteti 1.2</b> Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të organizatës							
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit				
			2018	2019	2020	2021	2022
1.2.1	Vlerësimi i performancës së stafit dhe përcaktimi i nevojave për zhvillim profesional	Drejtori ekzekutiv Bordi	x	x	x	x	x
1.2.2	Pjesëmarrja e stafit në aktivitete të ndryshme të zhvillimit profesional	Drejtori ekzekutiv	x	x	x	x	x
1.2.3	Angazhimi i praktikantëve për punë në CiviKos	Sekretariati	x	x	x	x	x
1.2.4	Analiza e mundësive për avancime teknologjike në CiviKos	Sekretariati	x				

1.2.5	Implementimi i risive teknologjike që avancojnë menaxhimin në CiviKos	Sekretariati		x	x	x	x	
<b>Aktiviteti 1.3</b> Qasje pro-aktive për sigurimin e fondeve								
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit					
			2018	2019	2020	2021	2022	
1.3.1	Hartimi i një politike për aplikim për fonde të donatorëve, duke mos rënë ndesh me interesin e organizatave anëtare	Sekretariati Bordi	x					
1.3.2	Prezantimi i Strategjisë së CiviKos para donatorëve	Drejtori ekzekutiv Bordi	x	x				
1.3.3	Negocimi me donatorë për financimin e aktiviteteve të CiviKos	Drejtori ekzekutiv	x	x	x	x	x	
1.3.4	Përfshirje në procesin e planifikimit të fondeve për shoqërinë civile	Sekretariati	x	x	x	x	x	
<b>Aktiviteti 1.4</b> Shtrirja e veprimtarisë së CiviKos në rajone								
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit					
			2018	2019	2020	2021	2022	
1.4.1	Përcaktimi i detyrave të qendrave rajonale	Sekretariati	x					
1.4.2	Përzgjedhja e OJQ-ve që do të veprojnë si qendra rajonale	Sekretariati	x	x	x			
1.4.3	Ndërtimi i kapacitetit të qendrave rajonale	Sekretariati	x	x	x	x	x	
1.4.4	Rrjetëzimi i qendrave rajonale	Sekretariati	x	x	x	x	x	

1.4.5	Veprimi i qendrave rajonale	OJQ-të e përzgjedhura	x	x	x	x	x
1.4.6	Monitorimi i punës së qendrave rajonale	Sekretariati	x	x	x	x	x

**Objektivi 2:** Mobilizim i organizatave anëtare përmes ndërveprimit të vazhdueshëm dhe ofrimit të shërbimeve cilësore

<b>Aktiviteti 2.1</b> Ofrimi i shërbimeve për organizatat anëtare							
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit				
			2018	2019	2020	2021	2022
2.1.1	Hartimi i instrumenteve për vlerësimin e kënaqshmërisë së organizatave anëtare me shërbimet e CiviKos	Sekretariati	x				
2.1.2	Sondazhi i kënaqshmërisë së organizatave anëtare me shërbimet e CiviKos	Sekretariati	x	x	x	x	x
2.1.3	Analiza e rezultateve të sondazhit	Sekretariati	x	x	x	x	x
2.1.4	Zhvillimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve	Sekretariati	x	x	x	x	x
2.1.5	Ofrimi i vazhdueshëm shërbimeve për organizatat anëtare	Sekretariati	x	x	x	x	x
2.1.6	Hartimi i udhëzuesit intern për ofrimin e shërbimeve	Sekretariati	x				
<b>Aktiviteti 2.2</b> Sigurimi i kontributit të organizatave anëtare në punën e Platformës CiviKos							
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit				
			2018	2019	2020	2021	2022
2.2.1	"Hartëzimi" i organizatave anëtare sipas fushave të	Sekretariati	x				

	ekspertizës						
2.2.2	Plani i përfshirjes së organizatave anëtare në punën e Platformës	Sekretariati	x	x	x	x	x
2.2.3	Rishikimi/Hartimi i instrumenteve për vlerësimin e kontributit të organizatave anëtare	Sekretariati	x				
2.2.4	Vlerësimi i kontributit të organizatave anëtare	Sekretariati	x	x	x	x	x
<b>Aktiviteti 2.3</b>	<b>Konsolidimi i anëtarësisë së CiviKos</b>						
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periodha e zbatimit				
			2018	2019	2020	2021	2022
2.3.1	Hapja e debatit rreth përshkallëzimit eventuale të statusit të organizatave anëtare të CiviKos	Bordi	x				
2.3.2	Analiza e zbatimit të Kodit Etik nga organizatat anëtare	Sekretariati	x				
2.3.3	Ndryshimet eventuale në Kodin Etik dhe Statutin e CiviKos	Bordi Kuvendi	x				
2.3.4	Monitorimi i zbatimit të kodit etik	Sekretariati		x	x	x	x

**Objektivi 3:** Avancimi i dialogut të strukturuar në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike

<b>Aktiviteti 3.1</b>	<b>Kontributi në procesin e hartimit të strategjisë së re të bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile</b>						
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periodha e zbatimit				
			2018	2019	2020	2021	2022
3.1.1	Pjesëmarrje në procesin e hartimit të Strategjisë	Sekretariati	x				

3.1.2	Zhvillimi i konsultimeve të brendshme rreth dokumentit të Startegjisë	Sekretariati	x					
<b>Aktiviteti 3.2</b> Lehtësimi i bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile								
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit					
			2018	2019	2020	2021	2022	
3.2.1	Shpërndarja e informacionit relevant tek organizatat anëtare	Sekretariati	x	x	x	x	x	
3.2.2	Plotësimi/Adaptimi i kornizës për monitorimin e Strategjisë së bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile	Sekretariati	x	x				
3.2.3	Organizimi i procesit të monitorimit të Strategjisë	Sekretariati	x	x	x	x	x	
3.2.4	Publikimi dhe promovimi i raporteve të monitorimit	Sekretariati	x	x	x	x	x	
3.2.5	Konsultë me organizatat anëtare rreth vendosje së bashkëpunimit me dikastere të tjera të Qeverisë	Sekretariati	x	x				
3.2.6	Bashkëpunim me dikastere të ndryshme të Qeverisë	Drejtori ekzekutiv	x	x	x	x	x	
<b>Aktiviteti 3.3</b> Lehtësimi i bashkëpunimit të shoqërisë civile me autoritetet lokale								
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit					
			2018	2019	2020	2021	2022	
3.3.1	Avokimi për zhvillimin e standardeve për konsultim publik në nivelin lokal	Bordi Drejtori ekzekutiv Organizatat anëtare	x					

3.3.2	Hartimi i kornizës për bashkëpunim në mes autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile	Sekretariati		x	x		
3.3.3	Ndërtimi i kapacitetit të organizatave anëtare për bashkëpunim me autoritetet lokale	Sekretariati			x	x	x
3.3.4	Mbajtja e komunikimit të rregullt me MAPL	Drejtori ekzekutiv	x	x	x	x	x
3.3.5	Zhvillimi i bashkëpunimit të organizatave anëtare me autoritetet lokale	Organizatave anëtare			x	x	x

**Objektivi 4:** Promovimi cilësor i punës dhe rezultateve të Civikos dhe organizatave anëtare

<b>Aktiviteti 4.1</b>		Angazhimi i një zyrtari për komunikim me anëtarët dhe publikun						
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit					
			2018	2019	2020	2021	2022	
4.1.1	Analiza e opsioneve për angazhimin e një zyrtari për komunikim	Drejtori ekzekutiv	x					
4.1.2	Angazhimi i një zyrtari për komunikim	Drejtori ekzekutiv	x	x	x	x	x	
<b>Aktiviteti 4.2</b>		Krijimi i "brandingut" të Civikos						
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit					
			2018	2019	2020	2021	2022	
4.2.1	Kontraktohet agjencia e marketingut për zhvillimin e BrandBook	Drejtori ekzekutiv	x					
4.2.2	Mblidhen të gjitha informatat e nevojshme për zhvillimin e BrandBook	Sekretariati Bordi	x					

4.2.3	Zhvillohet Brandbook në formë elektronike dhe shtypen edhe disa kopje sipas nevojës	Agjencia e marketingut	x				
<b>Aktiviteti 4.3</b>		Informimi i publikut për punën e CiviKos dhe organizatave anëtare					
Kodi	Veprimet	Përgjegjësia	Periudha e zbatimit				
			2018	2019	2020	2021	2022
4.3.1	Përditësohet ueb faqja dhe futen disa funksione të reja në atë ekzistuese	Zyrtari për komunikim	x	x	x	x	x
4.3.2	Përditësohet faqja e Facebook dhe dokumentohen të gjitha aktivitetet e CiviKos	Zyrtari për komunikim	x	x	x	x	x
4.3.3	Monitorohen mediat dhe shfrytëzohen mundësitë për rritjen e prezencës mediatike	Zyrtari për komunikim	x	x	x	x	x
4.3.4	Përgatiten materiale promovuese sipas nevojës të bazuara në planin kalendarik të aktiviteteve	Zyrtari për komunikim	x	x	x	x	x
4.3.5	Organizohet ngjarja promovuese dhe sociale në fund të vitit për të gjitha palët me interes	Sekretariati	x	x	x	x	x

## 8. Monitorimi i Strategjisë

Monitorimi i Strategjisë është pjesë përbërëse e zbatimit të saj dhe do të bëhet, si nga Sekretariati ashtu edhe Bordi i Civikos. Monitorimi do të përqendrohet në dy fusha:

1. *Monitorimi i aktiviteteve* ka të bëjë me përcjelljen e zbatimit të aktiviteteve që parashihen me Strategji. Si bazë për monitorim shërben plani i veprimit i dhënë në kapitullin 7, si dhe përshkrimet e aktiviteteve të dhëna në kapitullin 5. Ky lloj monitorimi do të organizohet nga Sekretariati, nën udhëheqjen e drejtorit ekzekutiv, për të kuptuar nëse aktivitetet zbatohen ashtu si janë planifikuar dhe sipas kalendarit të paracaktuar, si dhe nëse zbatimi i aktiviteteve kërkon burime që nuk janë paraparë me Strategji. Të dhënat për monitorimin e aktiviteteve do të mblidhen nga raportet e shkruara, takimet me stafin dhe, sipas nevojës, mbledhja e informatave nga palët e treta.

Monitorimi do të jetë më i lehtë nëse për secilin aktivitet, gjatë një periudhe raportuese përcaktohen disa pyetje orientuese për të cilat kërkohet përgjigje. Në tabelën 4 është dhënë shembulli i pyetjeve orientuese për aktivitetin 4.2 - “Krijimi i ‘brandingut’ të organizatës”. Me këtë rast është supozuar se përgatitjet për hartimin e Brandbook-ut fillojnë në gjysmën e parë të vitit 2017, për të përfunduar në gjysmën e dytë të këtij viti. Pyetjet orientuese kanë për qëllim të lehtësojnë raportimin dhe ato duhet t’i përshtaten situatës. Në parim, këto pyetje duhet të hartohen pasi të jetë e qartë se çfarë është realizuar në periudhën monitoruese paraprake dhe çfarë ka mbetur pa u realizuar.

**Tabela 4.** Shembull i pyetjeve orientuese për Aktivitetin 4.2

Periudha monitoruese	Pyetjet orientuese
1 janar-30 qershor 2018	<ul style="list-style-type: none"><li>• A është identifikuar agjencia e marketingut e cila do ta hartojë Brandbook-un?</li><li>• A i është komunikuar agjencisë kërkesa e plotë dhe gjithëpërfshirëse për “brandingun” e Platformës?</li><li>• A reflekton kjo kërkesë pritjet e Bordit dhe të menaxhmentit të organizatës?</li><li>• Cila ka qenë dinamika e konsultimeve me agjencinë?</li></ul>
1 korrik-31 dhjetor 2018	<ul style="list-style-type: none"><li>• Çfarë mund të thuhet për cilësinë e Brandbook-ut dhe funksionalitetin e zgjidhjeve të ofruara?</li><li>• A është Brandbook-u lehtësisht i zbatueshëm në punën e përditshme?</li><li>• A është regjistruar ndonjë ndikim pozitiv ose negativ i brendit të ri të Platformës?</li></ul>

2. *Monitorimi i objektivave* bazohet në përcjelljen e arritjes së treguesve të suksesit të definuar në kapitullin 5 të këtij dokumenti. Pjesa më e madhe e treguesve kanë të bëjnë me verifikimin e arritjes të një rezultati të caktuar, p.sh. treguesi i objektivit 4, “Faqja e Civikos në Facebook ka të paktën 5000 ndjekës me trend të rritjes”. Në raste të tilla, verifikohet nëse treguesi është arritur, respektivisht shpjegohet se në ç’ masë është arritur dhe jepet arsytim, nëse nuk është arritur në tërësi. Përveç kësaj, kemi edhe një kategori të treguesve që kërkojnë mbledhje të të dhënave të caktuara për të nxjerrë përfundim për shkallën e arritjes së tyre. Shembull konkret është treguesi i objektivit 2, “Mbi 50% të organizatave anëtare janë të kënaqur me shërbimet që ofrohen nga Civikos”. Për të nxjerrë përfundime për këtë tregues duhet bërë vlerësimin e kënaqshmërisë së organizatave anëtare.

Raportet e monitorimit do të hartohen çdo gjashtë muaj dhe do të përfshinë në vete të dhëna për monitorimin e aktiviteteve dhe të objektivave. Raportet e tilla do të përfundojnë me rekomandime të cilat duhet të merren parasysh me rastin e planifikimit të veprimeve për periudhat vijuese të zbatimit të Strategjisë.. Këto raporte do t’i dorëzohen Bordit të Civikos dhe do të përdoren për ta analizuar progresin e zbatimit të Strategjisë. Nga analiza e raporteve të monitorimit mund të rrjedhë nevoja për rishikimin e Strategjisë dhe të hapave për implementimin e saj.